

Test Trace Protect Albanian

TESTIM GJURMIM MBROJTJE
Prill 2021

Përditësuar

UDHËZIM HAP PAS HAPI

1. VËZHGONI SIMPTOMAT

Nëse keni një kollë të re të vazhdueshme, temperaturë ose humbje apo ndryshim në shije dhe nuhatje, ju dhe gjithë të tjerët në shtëpinë tuaj duhet të vetë-izoloheni menjëherë.

2. KËRKONI NJË TESTIM TANI

Vizitoni faqen nidirect.gov.uk/coronavirus për të rezervuar një testim online. Telefononi në numrin 119 nëse nuk mund të rezervoni një testim online.

3. IZOLOHUNI

Izolohuni për 10 ditë pas shfaqjes së simptomave, më gjatë nëse temperatura vazhdon (të paktën deri në 48 orë pas normalizimit të temperaturës). Njerëzit e tjerë që jetojnë me ju duhet të izoloohen për 10 ditë.

4. TESTOHUNI

Testimi kryhet në një sërë qendrash testimi pa qenë nevoja të zbrisni nga makina ose të lini takim, si edhe në njësi testimi të lëvizshme. Janë të disponueshme edhe testimet në shtëpi.

5. MERRNI REZULTATET

Ju duhet t'i merrni rezultatet brenda 48 orësh. Nëse rezultoni negativ me koronavirus, ju dhe familjarët tuaj mund të dilni nga izolimi. Nëse rezultoni pozitiv, gjurmuesit e kontakteve nga Agjencia e Shëndetit Publik do ju kontaktojnë.

6. JEPNI DETAJE

Ata do ju kërkojnë të përdorni programin Digital Self-Trace (Vetë-Gjurmim Digjital), shërbim në internet për gjurmimin e kontakteve, të vendosni detaje të njerëzve me të cilët keni qenë në kontakt. Nëse nuk mund të futeni në internet, ata mund t'ju telefonojnë nga numri 028 9536 8888.

7. ASHP INFORMON KONTAKTET

Kontaktet e ngushta do të marrin një mesazh nga HSCtracing (Gjurmim nga Shëndeti dhe Kujdesi Social) që i udhëzon ata të vetë-izolohen dhe rezervojnë një testim. Emri juaj nuk do të bëhet i ditur. Gjithë të dhënat do të mbahen në siguri të plotë.

8. KONTAKTET IZOLOHEN DHE KRYEJNË TESTIMIN

Kontakteve të ngushta do ju kërkohet të izoloohen për 10 ditë që nga hera e fundit që kanë qenë në kontakt me ju dhe të rezervojnë një testim. Ata duhet të izoloohen për 10 ditë të plota, edhe nëse rezultati i testit është negativ.

9. FAMILJARËT E KONTAKTEVE TË NGUSHTA

Nëse njëri nga kontaktet e ngushta nuk ka simptoma, familjarët e tjerë nuk kanë nevojë të izoloohen. Nëse ky kontakt i ngushtë shfaq simptoma ose del pozitiv, ata duhet të ndjekin këtë udhëzim duke filluar që nga hapi i parë.

Kur të dilni nga shtëpia, qëndroni i sigurt dhe vazhdoni të ndiqni këshillat e shëndetit publik.

- Lajini duart mirë dhe shpesh dhe shmangni prekjen e fytyrës.
- Ruani distancën nga të tjerët kur dilni jashtë.
- Kollituni ose tështini në bërrylin tuaj ose në një shami dhe hidheni shaminë në kosh.
- Vendosni një maskë në vende të mbyllura si dyqanet, njësitë e kujdesit ndaj shëndetit dhe në transportin publik.
- Shkarkoni aplikacionin StopCOVID NI për të mbështetur gjurmimin e kontakteve.

Ju mund ta transmetoni virusin edhe nëse nuk keni simptoma.

05/21